

PROCESVERBAL
nga seanca e 25-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 9.7.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Zirjeta Jajaga (pushim vjetor).

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Cvetanka Mitrevska, Magdalena D. Dovleva, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: Mirjana Trpčevska, përfaqësuese e ShTR TV 24 Vesti.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 25-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës 24. të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtura më 9.7.2026.
2. Propozim-aktvendim për refuzimin e Njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR 24 Vesti ShPKNJ P Shtip.
3. Propozim- vendim për refuzimin e Kërkesës për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radiotransmetim në nivel lokal, në zonën e komunës së Kavadarit.
4. Propozim për dhënien e miratimit për ndryshim dhe plotësim të Planit Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr.05-2219/1 të datës 22.5.2026.
5. Propozim për dhënien e pëlqimit për miratimin e vendimit për shlyerjen e borxhit nga evidenca kontabël e Agjencisë për ShTR Radio Uskana-Plus eksport-import ShPKNJ P Kërçovë.
6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të mallrave: licenca firewall.
7. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli ka anuluar miratimin e Propozim-procesverbalit të seancës 24. të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 9.7.2026, për shkak të periudhës së shkurtër kohore për përgatitjen dhe hartimin teknik të tij.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Propozim-aktvendimin për refuzimin e Njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR 24 Vesti ShPKNjPL Shtip. Ai shpjegoi se më 13 maj 2026, transmetuesi ka paraqitur Njoftim për ndryshimin e strukturës pronësore. Në përputhje me aktin nënligjor të Agjencisë, ndaj njoftimit është bashkangjitur gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga i cili rrjedh se pronari i transmetuesit është personi juridik "Komnet 328 ShPK Beograd". Në procedurën për përcaktim nëse janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e ndryshimit, nga të dhënat e disponueshme publikisht të Agjencisë së Regjistrave të Biznesit të Serbisë është konstatuar se më 13 shkurt 2026, kundër personit juridik "Komnet 328 ShPK Beograd" është hapur procedurë për likuidim të detyrueshëm dhe po atë ditë është publikuar njoftim për likuidim të detyrueshëm. Me qëllim përcaktimin e plotë të gjendjes faktike, Agjencia e vazhdoi afatin për veprim dhe kërkoi dokumentacion shtesë. Më 11 qershor 2026, transmetuesi paraqiti gjendjen aktuale nga Agjencia e regjistrave të biznesit të Republikës së Serbisë, nga i cili rrjedh se emri i plotë i pronarit është "Komnet 328 ShPK Beograd në likuidim të detyruar", dhe si përfaqësues ligjor është regjistruar likuidatori Zoran Kish. Drejtori theksoi se, pavarësisht afatit shtesë, nuk është paraqitur dokumentacion i plotë, dhe dokumentet e bashkangjitura përmbajnë të dhëna të ndryshme. Konkretisht, në gjendjen aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si pronari është cekur "Komnet 328 ShPK Beograd", ndërsa në regjistrin e Republikës së Serbisë, është cekur "Komnet 328 ShPK Beograd në likuidim të detyruar". Për shkak të kësaj mospërputhjeje në të dhëna, dhe në mënyrë që Këshilli të vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar plotësisht, propozohet që Njoftimi për ndryshimin e strukturës pronësore të refuzohet.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, pyeti nëse afati shtesë kishte për qëllim t'i lejonte transmetuesit të plotësonte dokumentacionin, duke marrë parasysh interesin e medias për të vazhduar të punojë pa ndërprerje.

Drejtori Trajčevski sqaroi se me miratimin e aktvendimit të propozuar, procedura për ndryshimin e strukturës pronësore do të përfundojë, por kjo nuk do të ndikojë në punën e transmetuesit, i cili do të vazhdojë të funksionojë në përputhje me strukturën pronësore ekzistuese. Ai theksoi se bëhet fjalë në veçanti për çështje administrative-juridike që pronari duhet t'i harmonizojë, dhe jo për çështje që ndikojnë në punën e mediumit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për refuzimin e Njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR 24 Vesti ShPKNjP Shtip, PA1 nr.02-132 të datës 13.5.2026, për shkak se është i paplotë dhe i paqartë, përkatësisht nuk përmban të dhëna të sakta, të plota dhe të harmonizuara reciprokisht me regjistrat publikë kompetentë, në mënyrë që të mund të iniciohet vendimmarrje e mëtejshme.

Për miratimin e Aktvendimit të njoftohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive 24 Vesti ShPKNjP Shtip.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pikat 3

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Propozim-vendimin për refuzimin e Kërkesës për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal në zonën e Komunës së Kavadarit. Ai shpjegoi se Agjencisë i është paraqitur kërkesë për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim të shërbimit programor në radio me përmbajtje muzikore-folëse në nivel lokal. Në përputhje me ligjin, Agjencia ka përgatitur Studim për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik, i cili ka përcaktuar se nuk ka arsyeshmëri për dhënien e lejes së re për shërbim të tillë programor në zonën e Komunës së Kavadarit. Prandaj, propozohet që Këshilli ta refuzojë kërkesën e paraqitur.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin refuzoi Kërkesën me shkrim, nr ark.08-1667/1 të datës 6.4.2026, për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor të radios muzikore-folëse në nivel lokal, në zonën e komunës së Kavadarit. Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Sektori për spërkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 4

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Propozimin për ndryshim dhe plotësim të Planit Vjetor për furnizim publik për vitin 2026. Ai theksoi se ndryshimet e propozuara rrjedhin nga vendimi i miratuar më parë i Këshillit për uljen e Planit Financiar për vitin 2026. Në këtë drejtim, nga Plani Vjetor do të mënjanohen gjashtë furnizime publike, për disa nga të tjerat do të zvogëlohen mjetet e parashikuara, dhe do të parashikohet furnizim publik i ri të sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim, sepse sistemi ekzistues nuk është në funksion. Drejtori informoi se pas miratimit të Planit për ndryshim, do të mbahet seancë e re, në të cilën do të merret vendim për zbatimin e furnizimi publik të përbashkët me Ministrinë e Sportit për furnizim të sistemi të ri për ftohje, ngrohje dhe ventilim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për ndryshim dhe plotësim të Planit Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 (teksti i pastruar), nr.05-2219/1 i datës 22.5.2026, me tekstin e propozuar.

Sektori për çështje juridike, të kryejë në mënyrë të njëpasnjëshme harmonizim të furnizimeve të përfshira në kapitujt I , II dhe III të Planit Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr. 05-2219/1 të datës 22.5.2026.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë (tekst të pastruar) të Planit Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, ndryshimet dhe plotësimet e Planit Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, t'i publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, arsyetoi Propozimin për shlyerjen e borxhit nga evidenca kontabël e Agjencisë në shumë prej

3.631 denarë, borxhi nga ShTR Radio Uskana -Plus ShPKNJ P Kërçovë. Ajo sqaroi se Këshilli i Agjencisë, në vazhdimin e parë të seancës së 8-të, të mbajtur më 4 mars 2024, miratoi vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio për shkak të mospagesës së kompensimit për ushtrimin e veprimtarisë radiodifuzive. Për periudhën në të cilën transmetuesi ka punuar, është lëshuar faturë në shumë prej 3.631 denarë, e cila nuk është paguar as pas skadimit të afatit ligjor. Prandaj, Agjencia ka filluar procedurë për pagesë të detyruar. Pas aktvendimit të formës së prerë, është dhënë urdhër përmbarimi, por ndërkohë Gjykata Themelore në Kërçovë ka hapur procedurë falimentimi, pas së cilës shoqëria është fshirë nga Regjistri Qendror më 10 korrik 2025 dhe ka pushuar së ekzistuari si subjekt juridik. Duke qenë se nuk ka mundësi për pagesën e kërkesës, në rastin konkret nga inventari për vitin 2025 është propozuar që borxhi të flyhet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që Drejtori i Agjencisë të miratojë Vendim për shlyerjen nga evidenca kontabël e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të borxhit të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion Radio Uskana-Plus eksport-import ShPKNJ P Kërçovë, në shumë prej 3.631,00 (tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një) denarë.

Vendimi për shlyerjen e borxhit të ShTR Radio Uskana-Plus eksport-import ShPKNJ P Kërçovë hyn në fuqi me ditën e miratimit.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për zbatimin e procedurës për furnizim publik të licencave për firewall-it. Ajo theksoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për fillimin e procedurës, sepse furnizimi është parashikuar në Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026, dhe mjetet janë siguruar në Planin Financiar të Agjencisë. Në përputhje me vlerën e parashikuar, procedura do të zbatohet si furnizim me vlerë të ulët, duke zbatuar dispozitat e Ligjit për furnizime publike që lidhen me këtë lloj procedure. Përveç kësaj, ajo informoi se të gjitha të dhënat relevante për furnizimin janë të përfshira në materialet e paraqitura anëtarëve të Këshillit, dhe procedura do të fillojë me publikim të njoftimit në Sistemin Elektronik për furnizime publike.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Drejtorin e Agjencisë për të kryer procedurën për furnizim publik mallra: licenca firewall.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik mallra: licencat e firewall-it është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor të furnizimit publik për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, (tekst i pastruar) nr.05-2219/1 i datës 22.5.2026, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani